

Vendim nr. 205 datë 25.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 25.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (S) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SILENA TOLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 134, datë 07.12.2023 dhe nr. 136, datë 11.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrit nr. 07 (87-2024-31) datë 27.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2024-934, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

BAZA LIGJORE: Nenet 27, 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 255 të vitit 2020 për veprat penale “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 258, 248 dhe 287 të Kodit Penal (KP). Objekt i hetimit lidhet me kontratën e koncesionit për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e vend-depozitimeve ekzistuese në Tiranë, të lidhur midis Ministrisë së Mjedisit, si autoriteti kontraktor, dhe shoqërisë “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k. (shoqëria fituese). Nga hetimet kanë rezultuar të dhëna për veprime të kundërligjshme të kryera para dhe gjatë procedurës së dhënies së koncesionit në lidhje me propozimin për dhënien e bonusit shoqërisë koncesionare, me hartimin dhe miratimin e dokumenteve standarde të koncesionit, me studimin e fizibilitetit, me regjistrimin e pronarëve përfitues fundorë të shoqërisë nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit etj.

2. Lidhur me kërkuesen, Prokuroria e Posaçme ka pasur dyshim të arsyeshëm se ka konsumuar veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 248 e 25 të KP-së. Dyshimi lidhet me faktin se kërkuesja, në cilësinë e drejtoreshës së Regjistrimit të Pronarëve Përfitues, ka vepruar në kundërshtim me ligjin organik të institucionit dhe vendimin e Këshillit të Ministrave të dalë në zbatim të tij, pasi ka miratuar një aplikim të shoqërisë fituese në regjistër me mungesë dokumentacioni.

3. Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 134, datë 07.12.2023, ka vendosur, ndër të tjera, caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, të parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) ndaj kërkueses. Masa është ekzekutuar në datën 08.12.2023 dhe brenda afatit ligjor 3-ditor, sipas nenit 248 të KPP-së, ajo gjykatë ka verifikuar kushtet dhe kriteret e zbatimit të masës së sigurimit duke marrë në pyetje kërkuesen dhe në përfundim, me vendimin nr. 136, datë 11.12.2023, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës ndaj kërkueses.

4. Vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është lënë në fuqi me urdhrin nr. 07 (87-2024-31), datë 27.01.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) për pjesën e kërkueses. Ajo gjykatë ka vlerësuar se veprat penale për të cilat hetohen personat nën hetim janë kryer në bashkëpunim në formën e grupit

të strukturuar kriminal dhe jo në formën e bashkëpunimit të thjeshtë, duke lënë edhe udhëzimet dhe detyrat përkatëse për prokurorin që po kryente hetimet.

5. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-934, datë 23.05.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se në të nuk janë ngritur shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 08.05.2025 kërkesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.05.2025. Në datën 10.06.2025 kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës me shpjegime shtesë lidhur me ankimin e saj kushtetues individual.

II

Pretendimet e kërkuases

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *Liria personale*, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë bërë një vlerësimi serioz dhe të argumentuar për mundësinë e aplikimit të një mase më të lehtë sigurimi ndaj kërkuases, por automatikisht kanë caktuar një nga masat më të rënda që cenojnë lirinë personale.

7.2. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

7.2.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* të lidhur me parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*), pasi GJKKO-ja e Apelit (gjyqtari i hetimeve paraprake) duke bërë ndryshim juridik të faktit penal, ka vepruar në tejkalim të kompetencave, pasi ka disponuar për çështje që i takojnë gjyqtarit të seancës paraprake dhe jo atij të hetimeve paraprake, duke rënduar në këtë mënyrë pozitën e kërkuases si person nën hetim edhe pse gjykata e apelit është vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të saj. Edhe Gjykata e Lartë nuk ka ushtruar detyrat e saj funksionale, duke mos e shfuqizuar këtë vendimmarrje të GJKKO-së së Apelit.

7.2.2. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi arsyetimi i GJKKO-së së Apelit përfaqëson një formë deklarative të fajësisë së kërkuases për kryerjen e veprës penale si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal. Për rrjedhojë, është cenuar edhe *aksesi efektiv në gjykatë*, pasi në këtë mënyrë fshihet në praktikë ndarja ndërmjet fazave procedurale. Ndërsa Gjykata e Lartë, ndonëse e ka evidentuar parregullsinë procedurale, nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të garantuar zbatimin e ligjit, duke cenuar edhe *parimin e sigurisë juridike*.

7.2.3. *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi në raste të tjera, ku është shkelur kompetenca nga ana e gjyqtarit të hetimit paraprak, Kolegji Penal ka mbajtur qëndrim të ndryshëm në vendimmarrjen e tij, duke bërë dallimin mes kompetencave të gjyqtarit të themelit dhe atij të seancës paraprake.

7.2.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi gjykatat nuk kanë kryer asnjë analizë për papërshtatshmërinë e masave më të lehta të sigurimit personal, duke disponuar me një prej masave më të rënda. Gjykatat nuk kanë arsyetuar lidhur me ekzistencën e kushteve të parashikuara nga neni 228/3 i KPP-së. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka bërë një arsyetim *copy-paste* të gjykatave më të ulëta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesses

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kolegji vëren se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuessin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Për sa më lart, Kolegji, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, çmon të ndalet në kriterin *ratione temporis*, për të cilin neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati

për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 08.05.2025, kurse vendimi gjyqësor që ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 23.05.2024. Kërkesja ka pretenduar se teksti i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk është publikuar asnjëherë, por është publikuar vetëm fakti se vendimi mund të tërhiqej pranë sportelit të gjykatës. Sipas saj, ajo ka marrë dijeni për vendimin vetëm pasi është interesuar pranë sportelit të Gjykatës së Lartë, pa përcaktuar një datë për këtë marrje dijeni. Për rrjedhojë, sipas saj, vonesa në paraqitjen e kërkesës është e justifikuar për shkak të mungesës së njoftimit nga Gjykata e Lartë. Ndërkohë, nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore të administruar për efekte të këtij shqyrtimi kushtetues, Kolegji vëren se, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 18.09.2024, avokatit të kërkeses i është dërguar nga administrata gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në adresën e *e-mail*-it të deklaruar në rekurs, vendimi i Kolegjit Penal.

12. Bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson se në situatën që njoftimi elektronik është parashikuar si një nga format e komunikimit të vendimeve të asaj gjykate, konsiderohet se momenti në të cilin kërkesja ka marrë dijeni efektivisht për përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar dhe shkaqet për të cilat është vendosur mospranimi i rekursit të saj, pra nga i cili ka filluar afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, është pikërisht data 18.09.2024. Për rrjedhojë, referuar kësaj date, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i depozituar në datën 08.05.2025 është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis*.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.